



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of
Education and Science*

Prishtinë, 09.07.2026

Në bazë të Rregullores MF- Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, **Ministria e Arsimit dhe Shkencës** *nxjerr këtë:*

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti

1. **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**, u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin e këtyre nxënësve

2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat prioritare në vijim:

- 1. Hartimi i programeve për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente.*
- 2. Ngritja e kapaciteteve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente.*
- 3. Përkrahja e garave për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.*

3. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë për një projekt që kontribuon në përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente nëpërmjet aktiviteteve të cilat mund të përfshijnë, por të mos kufizohen, në llojet e aktiviteteve si në vijim:

- ✓ Trajnimin e mësimeve, trajnerëve, psikologëve dhe profesionistëve të tjerë për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti në programet e akredituara;
- ✓ Trajnimin e mësimeve, trajnerëve, psikologëve dhe profesionistëve të tjerë për përdorimin e Udhëzuesit Praktik për Hartimin e Planit Individual për nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente në programet e akredituara.
- ✓ Organizimi i garave në nivel vendi me prioritet në fushën e matematikës, fizikës, teknologjisë informative dhe të tjera si dhe përkrahja për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare e fituesve të garave në nivel vendi.
- ✓ Aktivitete specifike mësimore dhe jashtë mësimore me fëmijë/ nxënës me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të institucioneve arsimore për identifikimin e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 170,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 50,000.00 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes dhe përfundon me datën 24.07.2026.

6. Një OJQ mund të aplikojë me më së shumti me një projekt në kuadër të kësaj thirrje.

7. Periudha e zbatimit të projektit është 8 deri në 12 muaj, duke filluar nga muaji shtator 2026.

8. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku 3 vite para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë

përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

8. Propozimet mund të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikuesit, janë në dispozicion në faqen e internetit *të MASHT*.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rruga “Agim Ramadani”, nr. 10000, Prishtinë.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: dijedona.ahmeti@rks-gov.net jo më vonë se 10 ditë para skadimit të thirrjes.